



KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Bedri Muhadri

Prizren, më 31.03.2020

Në mbështetje të nenit 17, paragrafi 3 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621 të datës 30 maj 2013, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit, duke vendosur në lidhje me kërkesën me nr. të protokollit 04 - 896 të datës, 17.12.2019 në mbledhjen e mbajtur më 12.03.2020 mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa me nr. të protokollit 04 - 896 e datës, 18.12.2019 e parashtruar nga Prof. Dr. Sadik Idrizi, për kompensim të pagave pas pensionimit dhe pagës jubilarë.

A r s y e t i m

Prof. Prof. Dr. Sadik Idrizi, ka parashtruar kërkesë për kompensim të pagave pas pensionimit dhe pagës jubilarë, bazuar në dispozitat ligjore të nenit 52 dhe 53 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të nënshkruar më, 18.03.2014 në mes të MASHT-it dhe BSPK-së.

Bazuar në dispozitat ligjore të nenit 165, paragrafi 1 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, ku decidivisht theksohet se: Vendet e punës bazohen në kontratat me normë të plotë dhe kontratat me gjysmë normë. Pasi që parashtruesi i kërkesës nuk ka pasur kontrat me normë të plotë apo kontrat ne gjysmë norme me Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, rrjedhimisht nuk ka pasur as vendim për pensionim nga ana e Universitetit, Këshilli Drejtues, vendosi që të refuzohet kërkesa si qartazi e pabazuar.

Nga sa u tha më lart dhe në mbështetje të Opinionit Ligjor me nr. të protokollit 03-44 të datës 11.02.2020 e lëshuar nga Zyra Ligjore e Universitetit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala mund të ushtrojë ankesë pranë Gjykatës Kompetente në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menaxhmentit;
- Të Përmendurit;
- Zyrës Ligjore;
- Arkivit.

Prof. Asoc. Dr. Bedri Muhadri

Kryesues i Këshillit Drejtues

